REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 108/17
Date/Datum 02.05.2017
PRISHTINË / PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

REFERENCË:	**108/17**
PËR:	- Zyrtarin e prokurimit të AK-së: **Komuna e Suharekës** - Parashtruesit të ankesës: **N.T.P. "Flamuri"- Suharekë.**
CC:	- Panelit Shqyrtues në OSHP, - Arkivës në OSHP
NGA:	Sabrije Bullatovci - Ekspert Shqyrtues i Prokurimit Qazim Hoxha- Ekspert teknik
TEMA:	Raporti i vlerësimit të ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar: **N.T.P. "Flamuri"- Suharekë**, me numër protokollit: **108/17**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Mirëmbajta dhe servisimi i automjeteve zyrtare", me nr. të prokurimit: 624/17/108/221.** Kundër vendimit të Autoriteti Kontraktues: (AK) – **Komuna e Suharekës.**

Lokacioni:	Prishtinë	Data:	02.05.2017
PËR AKTIVITET			X
SIÇ ËSHTË KËRKUAR			X
PËR KOMENTE			X
PËR INFORMIMIN TUAJ			X

Bazuar në nenin 113 dhe 114 të LPP të Kosovës, ju njoftojmë me raportin e ekspertizën lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Mirëmbajta dhe servisimi i automjeteve zyrtare", me nr. të prokurimit: 624/17/108/221,** iniciuar nga autoriteti kontraktues: (AK)– **Komuna e Suharekës,** si dhe me përgjigjen ndaj pretendimeve ankimore të OE ankues: **N.T.P. "Flamuri"- Suharekë**, me numër protokollit: **108/17.**

Konform nenit 113 dhe 114, Pjesa IX e LPP-së, eksperti shqyrtues i pavarur , ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë si dhe kërkesën e AK-së, dhe ka konstatuar si më poshtë:
AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë,të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bullagani		21.04.2017		21.04.2017		02.05.2017
Nënshkrimi i ekspertit		*Data e autorizimit të ekspertizës*		*Data e fillimit të ekspertizës*		*Data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën: **11.04.2017**, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. **108/16,** e parashtruar nga OE: **N.T.P. "Flamuri"- Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Mirëmbajta dhe servisimi i automjeteve zyrtare", me nr. të prokurimit: 624/17/108/221**, iniciuar nga autoriteti kontraktues: (AK)– **N.T.P. "Flamuri"- Suharekë**
Konform nenit 113, të Ligjit Nr. 04/L-042, si dhe konform njoftimit të OSHP-së të datës: 19.11.2014 me nr. prot. 848/14. Eksperti Shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) – **Komuna e Suharekës**

N.111,LPP - Operatori Ekonomik Ankues: N.T.P. "Flamuri"- Suharekë

Pikat e Ankesës:

Shkeljet e LPP-së:

- Neni 1 Qëllimi
- Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- Neni 26 Nënshkrimi i kontratave publike 4.1
- Neni 58 Hapja e Tenderëve
- Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës
- Shkeljet e Udhëzuesit dhe Rregullores se Prokurimit:
- Neni 18 paragrafi 18.4 28. Paragrafi 28.2

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Autoriteti Kontraktues gjate kësaj procedure te prokurimit ka bere disa shkelje te LPP-së dhe Rregullores dhe Udhëzuesit te Prokurimit Publik te Kosovës.

- Ne nenin 1 te LPP-së ne fuqi është parapare qe qëllimi i këtij ligji, është te siguroj mënyrën me efikase, me transparence dhe me te drejte te shfrytëzimit te fondeve publike, burimeve publike si dhe te gjitha fondeve dhe burimeve te tjera te autoriteteve kontraktuese ne Kosovë. Edhe pse ne, kemi ofruar tenderin i cili sipas kritereve për dhënie te kontratës, është tenderi me çmimin me te ulet te poentuar, Autoriteti Kontraktues duke shkelur dispozitat e këtij neni e ka shpërblyer me kontrate Operatorin Ekonomik i cili ka ofruar tender me çmimin me te larte.

- Ne nenin 6 te LPP-së është parapare se te gjitha autoritet kontraktuese, janë te obliguara qe te sigurojnë qe fondet publike dhe burimet publike te përdoren ne mënyrën me ekonomike, njëkohësisht duke marre ne konsiderate qëllimin dhe lenden e prokurimit, andaj me qene se autoriteti kontraktues e ka shpërblyer me kontrate operatorin ekonomik i cili ka ofruar tender me çmimin me te larte se ne, autoritetit kontraktues ka vepruar ne kundërshtim me dispozitat e këtij neni.
- Procedura te cilën e ka udhëhequr Autoriteti Kontraktues ka qene procedure e hapur me vlerë te mesme. Autoritetit Kontraktues ka parapare qe ta nënshkruaj kontratën me date 03.04.2017. Ne dispozitat e nenit 26 paragrafi 4 pika 1 është parapare qe se paku dhjete (10) dite duhet te kalojnë nga data e publikimit te njoftimit për dhënien e kontratës për te nënshkruar kontratën, ndërsa Autoriteti Kontraktues njoftimin e ka bere me date 27.03.2017, pra ka parapare qe kontrata te nënshkruhet brenda afatit prej 7 dite nga data e shpalljes se dhënies se kontratës. Ne baze te asaj qe u tha me larte del se Autoriteti Kontraktues ka vepruar ne kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

- Ne dispozitat e nenit 58 paragrafi 3 është parapare qe Zyrtari i Prokurimit do t'u lexoje me ze atyre qe Janë te pranishëm: (i) emrin dhe vendin e tenderuesit, (ii) çmimin e përgjithshëm te tenderit te specifikuar ne tenderin e ti//C dhe kur për arsye te Jo atypëratyshme mime(për njësi nuk mund te lexohen, çmimet e ti/la ne çdo rast duhet te bëhen te dukshme gjate hapjes publike për te gjithë përfaqësuesit e ofertuesve, si për shembull duke bere postimin e tyre ose duke përdorur ndonjë tjetër metode adekuate e cila garanton transparence. Ne çdo rast, secila faqe e çdo tenderi financiar do te nënshkruhet gjate hapjes publike nga një përfaqësues i një ofertuesi tjetër. Autoriteti Kontraktues gjate hapjes se tenderit ka lexuar vetëm çmimet totale te tenderit por Jo edhe çmimet sipas pjesëve te cilat kane qene te ndara ne A -çmimi për servisime te rregullta i poentuar me 60%; B — çmimi për mirëmbajtje dhe pjesët rezerve i poentuar me 20%; C- çmimi për riparime dhe ngjyrosje i poentuar me 5% dhe D- çmimi për pjesët e karrocerisë i poentuar me 15%, sikur Janë lexuar dhe shënuar ne procesverbalin e hapjes se tenderit te njëjte i shpallur për here te pare. Gjithashtu gjate hapjes se tenderit nga pjesëmarrësit ne hapje, nuk është nënshkruar e gjithë oferta financiare sikur është kërkuar ne dispozitën e nenit ne fjale por është nënshkruar vetëm pjesa ne te cilën Janë dhen pjesët e lartcekura, pra nuk Janë nënshkruar çmimet për njësi si dhe nuk Janë bere publike. Duke pasur parasysh natyrën e prokurimit ne fjale, me qene se çmimet nuk Janë nënshkruar ne hapjen publike te tenderit, ekziston mundësia qe çmimet te manipulohen te plotësohen dhe te ndryshohen pas hapjes se tenderit, sepse ne dosje te tenderit nuk është kërkuar qe te dorëzohet kopje pos pra autoriteti kontraktues ka vepruar edhe ne kundërshtim te dispozitave te këtij neni.

- Ne nenin 59 te LPP-s paragrafi 4 është parapare qe Autoriteti kontraktues do te konsideroje një tender si te përgjegjshëm vetëm nëse tenderi ne fjale është ne përputhshmëri me te gjitha kërkesat e parashtruara ne njoftimin e kontratës dhe ne dosjen e tenderit. Ne i kemi plotësuar te gjitha kërkesat e parapara ne dosje te tenderit dhe njoftimit për kontrate, mirëpo Autoriteti Kontraktues, nuk e ka marre për baze këtë fakt, andaj edhe na ka eliminuar nga pjesëmarrja e mëtutjeshme ne aktivitetin e prokurimit.

- Autoriteti Kontraktues ka bere edhe shkelje te dispozitave te nenit 60 te LPP-se paragrafi 1 pika 1.1 për arsye se ne dosje te tenderit dhe njoftimin për kontrate ka parapare qe tenderi do ti jepet Operatorit Ekonomik qe ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin me te ulet, ndërsa ka shpërblyer me kontrate Operatorin Ekonomik me çmim me te larte sipas poentimit.

- *Ne nenin 18 te Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik ne paragrafin 18.4 është parapare qe ne dosjen e tenderit AK do te deklaron te gjitha informatat relevante te kontratës ne fjale qe 0E-te te interesuar duhet te dine për përgatitjen e tenderëve pa kërkuar informata shtese. Informata te tilla do te përfshijnë te gjitha specifikimet, kërkesat, kriteret, afatet kohore, metodologjike, kushtet e kontratës, vizitat ne lokacion ose takime para-tenderuese etj. te lidhura me procedural e dhënies se kontratës. çdo fjali ne dosjen e tenderit do te përpilohet mire, pasi qe dosja e tenderit është materiali themelor, ne baze te cilit operatoret ekonomik do te krijojnë tenderët e tyre. Ne dosje te tenderit, përkatësisht ne çmimoren te cilën e ka ngarkuar Autoriteti Kontraktues ka pasur paqartësi dhe konfuzitet sa i parkete vendosjes se çmimeve për arsye se Autoriteti Kontraktues një pjese te konsiderueshme i ka shënuar me N/A te cilat i ka hijezuar, andaj ne kemi menduar se pjesët ne fjale nuk aplikohen, kështu qe për këtë arsye tenderi jone është konsideruar si i pa përgjegjshëm nga Autoriteti Kontraktues. Pra ne dosje te tenderit nuk ka pasur sqarime te mjaftueshme ne lidhje me plotësimin e çmimeve te kërkuara.*

- Ne nenin 28 te Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik ne paragrafin 27.12, është parapare qe ne rast te kontratave për shërbime te shumëfishta ose ne rast te kontratave me çmime për njësi, çmimet përfundimit mund te peshohen ne baze te rëndësisë se secilës "kategori te shërbimeve" ose "secilit" artikull ne mënyrë qe Autoriteti Kontraktues te përcaktoj se cila është oferta me çmim me te ulet. Ne këtë rast Autoriteti Kontraktues do te vlerësoj frekuencën dhe rendësin e secilit artikull ose frekuencën dhe rendësin e secilës kategori te shërbimeve dhe do te peshoj çmimin ne baze te rëndësisë. Këto pesha do te përdorën vetëm për qëllimin e artikullit te rëndësisë se secilit shërbim apo artikull, dhe për te qene ne gjendje për te zgjedhur ofertën me çmimin me te ulet. Autoriteti Kontraktues me rastin e vlerësimit të tenderit ka here shkeljen edhe te dispozitave te këtij neni për arsye se ka shpërblyer me kontrate Operatorin Ekonomik i cili ne baze te poentimit ka ofruar ofertën me çmim me te larte se oferta jone.

- ***Duke u bazuar ne atë qe u tha me larte, ne baze le nenit 109 te LPP-se dhe ne Rregullat për paraqitje e kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP-së dhe vlera e tarifave te ankesave neni 9, ne afatin ligjor paraqesim këtë ankese. Duke pasur parasysh se gjate procedurës së prokurimit ne fjale Janë bere shkelje te shumta te dispozitave lë LPP-së dhe Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, i propozojmë Organit Shqyrtues te Prokurimit qe te <u>Anulon</u> vendimin për dhënie te kontratës nga Autoritetit Kontraktues, dhe aktivitetin e prokurimit ta kthej ne Ri-tenderim duke bere përmirësimet e shkeljeve të procedurës se prokurimit ne fjale th cekura me lartë.***

<u>Dëmet material:</u>

Autoritetit Kontraktues me rastin e eliminimit tone nga pjesëmarrja e mëtutjeshme ne prokurimin ne fjale, do te na shkaktoje dëme materiale te cilat janë krijuar për përgatitjen e ofertës tone si dhe shpenzimet tjera ne lidhje me procedurën e prokurimit ne fjalë.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP:	02.02.2017
Lloji i procedurës së aplikuar:	Procedurë e Hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:	Shërbime/vlerë e Mesme
Vlera e parashikuar e kontratë:	27,200.00 Euro
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë):	28.02.2017
Data e hapjes së ofertave:	28.02.2017
Data e njoftimit për dhënie të kontratës në faqen e KRPP-së:	22.03.2017

Kriteret për vlerësim:

III.2) **KUSHTET PËR PJESËMARRJE**

III.2.1) **Kërkesat e përshtatshmërisë:**

a) Deklarata nën betim, qe tenderuesi i plotëson kërkesat mbi përshtatshmërinë ne pajtim me Ligjin Nr04L-042 a).

b) Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore, se ju nuk keni obligime/borxhe te tatimeve në ATK. Vlefshmëria e vërtetimit duhet te jete maksimumi 90 dite nga data e lëshimit deri ne datën e hapjes se ofertave. Vërtetimi kërkohet origjinal ose kopja e vërtetuar, vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit për Dhënie të Kontratës.

c) Dëshmi se kompania (biznesi) nuk është ne falimentim ose nën administrim te dhunshëm gjyqësorë te lëshuar nga Gjykata kompetente. Vërtetimi kërkohet origjinali ose kopja e vërtetuar, vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit për Dhënie të Kontratës dhe nuk duhet te jete me i vjeter se 180 dite nga data e lëshimit deri ne ditën e dhënies.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

a) Deklarata nën betim e nënshkruar dhe e vulosur (ky dokument është pjesë e dosjes)

b) Vërtetimi i ATK (i verifikuar ne ëeb faqen e ATK-se).

c) Vërtetimi nga gjykata kompetente (Origjinal ose kopje e noterizuar).

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

1. Regjistrimi i operatorit ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit (kopje)
2. Certifikata e Numrit Fiskal, nëse nuk është e përfshire ne certifikatën e biznesit (kopje)
3. Certifikata për Regjistrim në TVSH e lëshuar nga ATK (kopje)

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Çertifikata e regjistrimit te biznesit, se bashku me dokumentin Informatë mbi Bizneset (kopje).
2. Çertifikata e Numrit Fiskal, nëse nuk është e përfshire ne certifikaten e biznesit (kopje)
3. Çertifikata per Regjistrim në TVSH (kopje)

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatori ekonomik duhet te ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi i Operatorit Ekonomik, gjatë tri viteve të fundit (2014,2015,2016) ka qenë prej jo më pak se 50,000.00 Euro.
2.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Dokument nga banka për qarkullimin e OE në tri vitet e fundit 2014,2015,2016, ose pasqyrat e auditura financiare për tri vitet e fundit 2014,2015,2016 ose deklaratat vjetore tatimore te dorëzuara ne ATK për vitet 2014,2015,2016.

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

1. Operatori Ekonomik duhet te ofroje dëshmi se ka realizuar projekte te ngjashme ne tre vitet e fundit (2014,2015,2016) ne vlerën prej se paku 40,000.00 euro, ku përfshihen titujt e projekteve, vlera, numri, data e kontraktimit DHE dëshmi për përfundimin me suksese te këtyre projekteve.
2. Automjeti për bartjen-tërheqjen e automjeteve
3. Operatori Ekonomik duhet të ketë hapësirë të mjaftueshme të objektit minimum 100m2 ne një distance jo me larg se 15km nga Objekti i Komunës Suharekës.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Të paraqitet lista e shërbimeve të ngjashme të realizuar në tri vitet e fundit (2014,2015,2016) e vërtetuar nga Operatori Ekonomik, ku përfshihen titujt e shërbimeve si dhe dëshmi referenca.
2. Të dëshmohet me librezë valide të regjistrimit të automjetit dhe fotografi. Nëse Automjeti nuk është ne pronësi te OE, kontrata apo marrëveshja për shfrytëzim.
3. Deklarate me shkrim nga OE se do te ofroje Hapësirën e objektit e cila duhet të dëshmohet me fotografi, skicë apo dokumentacion tjetër dëshmues për pronësi ose marrje me qera.

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr.	Emri i OE	Vendi	Çmimi
1.	D.P.Z. "BELTI"	Suharekë	55,215.69€
2.	D.P.Z. "AUTO FORD&MBG"	Prizren	20,562.50€
3.	N.T.SH "KRASNIQI"	Suharekë	78,150.40€
4.	D.P.Z. "AUTOSERVIS FATONI"	Suharekë	144,979.80€
5.	N.T.P. "FLAMURI"	Suharekë	86,349.00€

6.	D.P.Z. "AUTOSERVIS FLAMURI"	Suharekë	115,839.60€

Sipas Procesverbalit të Hapjes së Tenderëve me datën: 27.12.2016, konstatohet se në hapjen e ofertave kanë marrë pjesë përfaqësuesit e gjithë OE, ku është lexuar emri i operatorit ekonomik, vendi dhe çmimi. Procesverbali i hapjes është nënshkruar nga anëtarët e komisionit të hapjes pranë AK-së.

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- Shaban Asllanaj, Kryesues i komisionit
- Xhevat Rexhaj, Anëtar i komisionit
- Ragip Berisha, Anëtar i komisionit
-

Data e fillimit dhe mbarimit të vlerësimit:.....13.03.2017

Data e nënshkrimit te raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:.....22.03.2017

Raporti i komisionit vlerësues:

Bazuar në raportin e vlerësimit të tenderëve, komisioni vlerësues konstatoj se 6 (gjashtë) operator ekonomik që kanë ofertuar, ne aktivitetin e prokurimit **"Mirëmbajta dhe servisimi i automjeteve zyrtare", me nr. të prokurimit: 624/17/108/221**, ku 4 (katër) operator ekonomik i plotësojnë kriteret e përzgjedhjes të kërkuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, ndërsa 3 (tre) operator ekonomik janë të papërgjegjshëm pasi që nuk plotësojnë kriteret e përzgjedhjes të kërkuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë .

- OE "FORD" Prizren, nuk ka ofruar referenca siç janë kërkuar me dosje por vetëm ka ofruar kontrata.
- OE "FATONI" Suharekë, nuk ka ofruar referenca siç është kërkuar me dosje.
- OE "BELTI" Suharekë, nuk ka ofruar listë të kontratave dhe nuk ka ofruar referenca për kontratat e prezantuara.

OE "Krasniqi" ka 100 pikë në bazë të nën kritereve për jo normalisht të ulët dhe është fitues për vlerën e parashikuar të kontratës prej 27,200.00€.

Analiza dhe konstatimet e ekspertit teknik (Neni 113, 114)

Sqarim hyrës

Autoriteti Kontraktues - Komuna Suharekë, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është shërbim, kontratë publike (kornizë – 12 muaj) me vlerë të mesme. Operatori ekonomik ankues: NTP "Flamuri" nga Suhareka, ka parashtruar ankesë kundër propozimit për dhënie të kontratës. Kundër të njëjtit njoftim, i njëjti OE më datën 31.03.2017, përmes shkresës së dorëzuar në kopje fizike, paraqet kërkesë për ri-shqyrtim tek AK, me pretendimet ankimore se komisioni i vlerësimit ka gabuar me kualifikimin si të papërgjegjshme të ofertës së tyre duke e eliminuar nga tenderi në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.
Kundrejt të njëjtës kërkesë AK – Komuna Suharekë, me datën 03.04.2017, nxjerr vendim me të cilin e refuzon kërkesën si të pa bazuar.

Konstatimi Nr. 1:

Nga ekzaminimi i shkresave, gjetjet tona tregojnë se boshti i problemit qëndron tek eliminimi i ofertës së palës në ankesë për arsye të mosplotësimit të disa pozicioneve të çmimit për njësi.
Pra, rrjedhimisht fokusi i ankesës përqendrohet në kundërshtimin e eliminimit të tyre për arsye të mosplotësimit të këtyre pozicioneve të çmimit për njësi, përkatësisht lënies krejtësisht të zbrazët në 6 pozicione të çmimit për njësi.

Sipas palës, ky lëshim ka rrjedhë si pasojë e dosjes së paqartë. Me qëllim të mbrojtjes së këtyre pretendimeve në ankesë, pala thirret edhe në disa paragrafe ligjorë (Neni 59,paragrafi 4 i LPP; neni 18.4 i UOPP të KRPP) ku precizohet nevoja e dhënies së informacioneve të qarta përmes Dosjes për pjesëmarrësit në tender.
Konkretisht, në një pikë ankuesi precizon se " ...në dosje të tenderit nuk ka pasur sqarime të mjaftueshme në lidhje me plotësimin e çmimeve të kërkuara".
Në përgjegjje të këtij pretendimi, vlerësojmë se pala ka bërë lëshim të pa riparueshëm kur nuk i ka plotësuar çmimet për njësi në të gjitha pozicionet e përshkruara. Me këtë rast konstatojmë se AK ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore, sepse nuk lejohet mos vendosja e vlerës numerike në pozicionet e çmimeve, madje as zeroja nuk do të pranohej si vlerë edhe po të ishte vendosur.

Ky veprim është në kundërshtim me kërkesat e Dosjes së Tenderit, gjegjësisht kërkesës së formularit " *Përshkrimi i çmimeve*". Për më tepër, Udhëzimi i KRPP, rreth këtyre situatave rikonfirmon të drejtën e AK për eliminim të ofertës, ku tekstualisht qartësohet se:
"Nëse Operatori Ekonomik ofron çmimin "0.00" në një nga pozicionet, tenderi duhet të refuzohet ngase në "Përshkrimin e çmimeve" kërkohet të vendoset çmimi në vlerë të caktuar për secilin artikull/pozicion të kërkuar në specifikimin teknik."

Konstatimi Nr. 2:

Konstatimi Nr. 2:

Në 2 pikat e para të ankesës pala pretendon se janë shkel dispozitat e nenit 1- Qëllimi i prokurimit dhe neni 6- Ekonomiciteti, për arsye të mos respektimit të kriterit themelor për dhënie te kontratës operatorit që ka ofruar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët.
Ky pretendim është i pabazuar për arsye se çmimi më i ulët si kriter gjithnjë u referohet ofertave që janë kualifikuar të përgjegjshme.
Paradoksi qëndron tek mospranimi i faktit se ky OE ka qenë vetë i papërgjegjshëm, prandaj ky pretendim është i përgjithësuar dhe krejtësisht i pabazuar. Argumentimi i palës se ata kanë ofruar çmimin më të lirë të ofertës krahasuar me fituesin aktual, është e qartë që nuk e mbulon edhe komponentin e përgjegjshmërisë që kërkohet me DT.

Prandaj, në përputhje me analizën e mësipërme vlerësojmë se pretendimi i palës në ankesë në këtë pikë është i pabazuar.

Konstatimi Nr.3:

Në këtë kontekst, duhet sqaruar edhe arsyetimin e palës se gabimi ka rrjedhë për shkak të dosjes së paqartë. Në këtë pikë përgjigja është e thjeshtë dhe konkrete. Në çdo rast kur operatorët kanë paqartësi, mund ta shfrytëzojnë të drejtën ligjore për sqarime shtesë për çdo paqartësi para se të dorëzohet oferta, sipas nenit 53 të LPP, gjë që ankuesi nuk e ka bërë.

Konstatimi Nr. 4:

Më tej, në përgjigje të pretendimit se AK ka anashkaluar procedurat e hapjes dhe vlerësimit, konsiderojmë se kjo më tepër është një përpjekje për ta rikthyer tenderin me anulim eventual për gabimet procedurale të AK, se sa ndonjë pretendim real për shkelje ligjore.

Arsyetimi se përveç çmimit total në hapje te tenderit nuk janë lexuar çmimet për njësi, nuk ka bazë ligjore, sepse dispozitat e nenit 58, paragrafi 3, ndër të tjera, precizojnë se:

"Zyrtari përkatës i prokurimit e bën hapjen e tenderëve. Gjatë hapjes së çdo tenderi, Zyrtari i Prokurimit do t'u lexojë me zë atyre që janë të pranishëm: (i) emrin dhe vendin e tenderuesit, (ii) çmimin e përgjithshëm të tenderit të specifikuar në tenderin e tillë dhe, kurdo që është e mundur, çmimet për njësi, përveç kur dokumenti përkatës është vetëm komponenti i propozimit teknik të tenderit dypjesësh, dhe ndonjë vërejtje."

Pra, është e qartë se leximi i çmimeve për njësi është i preferuar por jo obligativ.

Po ashtu e vlerësojmë të pa bazë edhe pretendimin se nuk janë lexuar nën totalet sipas përqindjeve, por vetëm çmimi total. Ky pretendim do të arsyetohej po të ishte kriter çmimi ekonomikisht më i favorshëm (kriteri i aplikuar për shpërblim sipas DT ka qenë çmimin më i ulët, v.j.), ku sipas të njëjtit nen përcaktohet që të shkohet në lexim më të thelluar të shifrave në hapje :
"Në rast të aktivitetit të prokurimit ku kriter i shpërblimit të kontratës është tenderi ekonomikisht me i favorshëm çdo gjë që ka të bëjë me numra duhet të lexohet si afati i dërgesës, periudha e garancionit dhe të ngjashme."

Pretendimi se për shkak të mos leximit të nën totaleve ka pas hapësirë për manipulim të çmimit total, na duket i pavend për arsyen e thjeshtë se në vlerësim krahasimi bëhet vetëm mes çmimeve totale të ofertave. Këto kuotizime shërbejnë vetëm për krahasim brenda vetë ofertës së secilit operatorë konform nenit 52.6 e LPP: "Në rast të çmimit më të ulët, duke peshuar çmimet, çmimet e peshuara bazohen në çmimin e ofruar nga Operatorët Ekonomik individual, prandaj nuk lejohet që të përcaktohen pikët duke krahasuar çmimet e ofertuesve të ndryshëm."

Ndërkaq, vërejtja se procesverbali nuk është nënshkruar në mënyrë të ndërsjellë nga të gjithë pjesëmarrësit qëndron, por ky fakt nuk e ka parandaluar ankuesin që të jap vërejtje me shkrim për këtë lëshim në procesverbal. Mos nënshkrimi i procesit nuk është ndonjë shkelje që ka mund të ndikoj substancialisht në proces, natyrisht kur nuk ka ndonjë vërejtje në hapje.
Po ashtu, për çfarëdo dyshimi për manipulim me dokumentacionin, palës do t'i sugjeronim të kërkojë hapjen e kopjeve të obligueshme për prezantim para OSHP-s, e nëse një gjë të tillë nuk mund ta sigurojë, atëherë AK-ja do ta penalizonte vetë veten për dështim në informim me kohë përmes DT për numrin e kopjeve të nevojshme, duke e lënë të hapur mundësinë e anulimit të tenderit.

Sidoqoftë, konstatoje se për shkelje te tilla procedurale, legjislacioni i prokurimit nuk parasheh ndonjë masë konkrete penalizuese e as ndonjë pezullim apo anulim të procesit. Kjo përgjegjësi bie mbi organet menaxheriale e audituese interne e eksterne, të cilat do të duhej të përcaktonin shkaqet e lëshimeve të tilla, dhe të njëjtat t'i penalizonin për performancë të dobët apo edhe arsye të tjera për neglizhim në zbatim të procedurave.

Konstatimi Nr. 5:

Pretendimi lidhur me njoftimin për nënshkrimet kontratës vlerësojmë se është i pabazuar, për arsye se njoftimi i publikuar për dhënie të kontratës, përkatësisht data e parashikuar, nuk nënkupton se patjetër nënshkrimi duhet të ndodh në atë datë. Për më tepër, kontrata nuk është nënshkruar ende prandaj nuk mund të gjykohet se AK-së ka gabuar.
Në fakt, vërejmë se data e përgatitjes së publikimit për dhënie është më 22.03.2017 dhe në të njëjtin dokument më poshtë jepet data e parashikuar më 03.04.2017, me afat ligjor më tepër se 10 ditë, konform nenit 26, paragrafi 4 i LPP. Se çfarë mund të ndodh deri sa të publikohet në KRPP, apo edhe si në rastin konkret të ankesës, AK-së nuk ka mund ta dijë paraprakisht. E rëndësishme është që pas publikimit në KRPP të realizohet pritja faktike ligjore prej 10 ditësh deri në nënshkrim, pavarësisht parashikimit në publikim.

Shkeljet e konstatuara të LPP-së

Konstatojmë se në disa elemente ka pas anashkalim të procedurave prokurimit, siç u konstatuan me ekspertizë, por vlerësimi ynë është se këto devijime nuk kanë pas ndikim substancial në procesin e vlerësimit dhe përzgjedhjes së operatorit fitues të tenderit.

Përgjigjet në pikat e ankesës

Përfundimisht, lidhur me të gjitha pikat e ankesës, tashmë dhamë përgjigjet detaje më lartë, prandaj nuk po i përsërisim më tej.

Mendimi i ekspertëve shqyrtues:

Ekspertët shqyrtues, duke u mbështetur në ekzaminimin e fakteve të prezentuara në dosjen e tenderit si dhe rrjedhën e vlerësimit nga ana e AK-s, rekomandojnë që ankesa e OE NTSH "Flamuri" me seli në Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve zyrtare", me Nr. të prokurimit 624-17-108-221, të iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna Suharekë të,

R E F U Z O H E T

Njëkohësisht, i rekomandojmë Panelit Shqyrtues që të aprovohet vendimi AK-s dhe të njëjtit t'i lejohet të vazhdojë me procedurat e mëtejme të përmbylljes së procesit me dhënie dhe nënshkrim të kontratës fituesit të publikuar të tenderit.